

UDHËZIM
Nr. 90, datë 2.4.2014

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES
SË SHPALLJES, PËR KËRKESËN E NDRYSHIMIT
TË EMRIT/MBIEMRIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Forma dhe përmbajtja e shpalljes për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit, e cila duhet t’u njoftohet nëpërmjet publikimit, personave të interesuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të kërkuesit, apo atyre personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuar, të jetë sipas modelit, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Prefekti, pasi kryen verifikimet mbi dosjen dhe çmon se janë përmbushur kërkesat dhe procedurat e ligjit për gjendjen civile, përsa i përket ndryshimit të emrit/mbiemrit, për shkak të papërshtatshmërisë, urdhëron afishimin e shpalljes së kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa dhe ku kërkuesi ka vendbanimin, si dhe në dy prej gazetave dhe/ose në Fletoren Zyrtare, për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

3. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefekti i qarkut, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarkut.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PUBLIKIM KËRKESE PËR NDRYSHIMIN EMRI/MBIEMRI

Në shqyrtim të praktikës për ndryshimin e emrit/mbiemrit, për shtetasin _____, të paraqitur në zyrën e gjendjes civile të bashkisë/njësisë (emër, mbiemër) bashkiake/komunës _____, ku shtetasi në fjalë ka vendbanimin e tij, banues në _____, pasi janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, në zbatim të pikës 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, sot më datë ____ . ____ . ____ prefekti i qarkut _____ autorizon publikimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit të shtetasit për shkak të papërshtatshmërisë

nga: _____

në: _____

Në zbatim të nenit 57/5 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

Shpallur në _____, më datë ____ . ____ . _____